

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Gjermani/ Zgjedhjet lokale në Saksoninë e Poshtme, CDU del e para! AfD trefishon rezultatin dhe ngjitet në vendin e tretë
ADRESA	https://www.gazetatema.net/bota/gjermani-zgjedhjet-lokale-ne-saksonine-e-poshtme-cdu-del-e-para-afd-trefish-i586128
BURIMI	gazetatema.net
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	14 shtator 2026, 19:38:08 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	14 shtator 2026, 20:00:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	de8b1040f8419545c86923f400b3820cad3c4e87c122fc057671fe2ce67d362b
TEKSTI	202763764090334b2560a5ca0a33bee6e58684ddd5679332d1274ed753614c49
PAMJA	3263d95cfb6aafa4947e1d6ce12cabf0ce970bc4ad4a06bc85ffcde666fcf80e

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	55c3a5ce99448dd942378757946243af13b70e7163fde9120ce9c5a722995118
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	—
ANKORIMI	nuk është ankoruar ende <i>Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërin nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahase hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/55c3a5ce99448dd942378757946243af13b70e7163fde9120ce9c5a722995118>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- [Politika](#)
- [Sociale](#)
- [Kronika](#)
- [Ekonomia](#)
- [Editorial](#)
- [Antena](#)
- [Blog](#)
- [Rajoni](#)
- [Bota](#)
- [Kulturë](#)
- [Sport](#)
- [Lifestyle](#)

English

Built and Monetized by

[Kontakt](#)



English



1 e Greqia i kerkon Parlamentit European heqjen e imunitetit te deputetit socialist te PASOK-ut, Nikos Papandreu Nga nje 'like' ne Instagram te propaganda serbe, si u shemb fundit

Gjermani/ Zgjedhjet lokale në Saksoninë e Poshtme, CDU del e para! AfD trefishon rezultatin dhe ngjitet në vendin e tretë



14 Shtator 2026, 22:00Bota TEMA



Në zgjedhjet komunale në Saksoninë e Poshtme, CDU-ja ka dalë sërish forca më e madhe politike dhe ka zgjeruar epërsinë e saj ndaj SPD-së. AfD-ja renditet në vendin e tretë.

Mes debateve rreth kancelarit federal Friedrich Merz, pas humbjes në landin Saksoni-Anhalt, CDU-ja është bërë forca më e madhe politike në zgjedhjet komunale të landit të Saksonisë së Poshtme (Niedersachsen). Në nivel qarqesh, ajo arriti në 27,2 për qind të votave. Sipas rezultatit paraprak të publikuar në portalin zgjedhor të landit, SPD-ja mori 24,6 për qind.

AfD-ja shënoi rritje dhe arriti në 15,9 për qind. Të Gjellbrit morën 14,1 për qind, E Majta (Die Linke) 6,0 për qind, ndërsa FDP-ja 3,7 për qind.

Pjesëmarrje e lartë në zgjedhje

Në zgjedhjet e mëparshme për qarqet, të mbajtura në vitin 2021, CDU-ja kishte dalë forca më e madhe me 31,7 për qind, e ndjekur nga SPD-ja me 30,0 për qind. Të Gjellbrit kishin arritur 15,9 për qind, FDP-ja 6,5 për qind, AfD-ja 4,6 për qind, ndërsa E Majta (Die Linke) 2,8 për qind. Rritjen më të madhe e ka shënuar AfD-ja, duke arritur rezultatin më të mirë ndonjëherë në zgjedhjet komunale në Saksoninë e Poshtme. Ndërkohë, CDU-ja dhe SPD-ja kanë humbur mbështetjen krahasuar me zgjedhjet e mëparshme.

Pjesëmarrja në votime arriti në 64,6 për qind, duke shënuar një rritje të konsiderueshme. Pesë vjet më parë kishin votuar 57,0 për qind e qytetarëve me të drejtë vote. Këtë herë, rreth 6,3 milionë persona kishin të drejtën të merrnin pjesë në zgjedhje.

"Kemi vënë re pakënaqësinë ndaj Berlinit"

Kryetari i CDU-së në Saksoninë e Poshtme, Sebastian Lechner, u shpreh optimist që disa orë para publikimit të projeksioneve të para se partia e tij do të dilte forca më e madhe në rang të landit. Ai tha se ishte i bindur se CDU-ja e landit mund të shkëputej nga tendenca negative në nivel federal dhe se kishte një shans shumë të mirë të bëhej sërish forca kryesore politike në Saksoninë e Poshtme. "Ju e dini se këto zgjedhje komunale nuk janë zhvilluar në rrethana të lehta. Edhe ne e kemi vënë re pakënaqësinë ndaj Berlinit", tha Lechner, duke iu referuar klimës politike në nivel federal. Kryetari i SPD-së në Saksoninë e Poshtme dhe njëherazi kryeministri i landit, Olaf Lies, e cilësoi rezultatin e zgjedhjeve si të vështirë për partinë e tij: "Kishim shpresuar të gjithë për më shumë

se kaq." Me këtë deklaratë, Lies pranoi zhgënjimin brenda SPD-së për rezultatin e arritur në zgjedhjet komunale./DW

 Lini një Përgjigje

Koment *

Emër *

POSTOJE KOMENTIN

[Gjermania urdhëron ushtarët të shërbejnë në Lituani për shkak të mungesës së vullnetarëve](#)

Skandal korrupsioni në Ukrainë, Zelensky pezullon prokurorin e përgjithshëm pasi ai largohet nga vendi

20:40 Bota

Prëzohet avioni në Gjermani, tre të vdekur

20:20 Bota / 1 koment

Vdes në moshën 107-vjeçare i mbijetuari më i vjetër i Holokaustit në Izrael

20:10 Bota / 1 koment

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.